

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ sipas gjyqtarës Hysnije Gashi, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Imrane Shabani ,në procedurën kundërvajtëse kundër Ferinaze Isufi nga fshati Lloshkobare KK Ferizaj , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.6 par.1.3 neni 9 dhe neni 17 par.1.3 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë së zyrtarve të Lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Ligji nr. 04/L-050), dhe neneve 31,73 ,dhe 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me datë 29.11.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehures Firinaze Isuf Isufi e lindur më 15.05.1958 në fshatin Lloshkobare , me vendbanim në fshatin Lloshkobare KK Ferizaj .Delegate në Kuvendin Komunal në Ferizaj, e martuar 3 fëmijë, shkollen e mesme dhe apsulvente e shkolles së lartë . për kundërvajtjen e cila i ngarkohet në mungesë të provave e në vështrim të nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të Gjykatës.

Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Agjensioni kundër Korrupsionit në Prishtinë ,kësaj gjykate i parashtroi kërkesat nr. 01-2190 /2012 të dates 04.06.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehures Ferinaze Isufi , për shkak të kundërvajtjes bga neni 5.6 par.1.3 , neni 9 dhe 17 par.1.3 të ligjit nr.04/L-040/.

Gjyatarja filloi procedure kundërvajtëse , mori në pyetje të pandehuren e cila në mbrojtjen e sajë deklaroi se si delegate e Kuvendit Komunal në Ferizaj, unë personalisht nuk kamë pranuar formularin për deklarimin e pasurisë dhe as që kamë qenë e njohtuar se prej dates 01.deri me 31.03.2012 duhet ta plotësoi të njejtin, nuk kamë pasur asnjë arsye që mos ta plotësoi formularin përveq se nuk kamë qenë e njohtuar nga zyrtari Naser Musa dhe për këtë jamë njohtuar nga medijat pastaj me daten 11.09.2012 kamë bërë deklarimin e pasurisë të cilën ia prezentoj Gjykatës si provë .

Për vertetimin sa më të plotë të gjendjes faktike gjyqtarja ftoi personin kontaktues me zyrën e Agjensionit kundër korrupsionit Naser Musa I cili në deklaratën e tij thekësoi se nga Agjensioni kundër korrupsionit ka pranuar njoftimin për zyrtarët e lartë të cilët kanë qenë të obliguar që ta bëjnë deklarimin e pasurisë pastaj unë në konsultim me kryesuesin e Asmbles komunale Agim Aliun dhe zyrtarin për marratje të Kuvendit Afrim Matoshin jemi konsultuar dhe forumularët për deklarimin e Pasurisë I kemi vendosur në tavolinat e delekatëve komunal ku para fillimit të séances së kuvendit kryesuesi I ka njohtuar të gjith delegatët se materialin e kanë të vendosur në tavolinë dhe të njejtin duhet ta plotësojnë dhe ta përcjellin në Agjension kundër korrupsionit si dhe prezeton listen e deklegatve të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjen e dates 09.03.2012 .

Gjyqtarja mori deklaratën e dëshmitarit Afrim Matoshi zyrtar për marrvajtjen e Kuvendit komunal në Ferizaj, I cili deklaroi se formularët i kamë vendosur në ulset e deputetve dhe se kryesusi I kuvendit I ka njohtuar deklegatët se duhet të plotësohen dhe të dorzohen në Agjensionin kundër korrupsionit.

Dëshmitari Agron Behrami zyrtar në Agjensionin kundër korrupsionit , I cili deklaroi se sa I përket kërkeses së parashtuar në bazë të Ligjit , në listen e zyrtarve të lartë të cilët duhet të deklarojnë pasurinë ka hyrë edhe një numer I zyrtarve të cilët më herët nuk e kanë deklaruar ,ne kemi njohtuar personin zyrtar kontaktues Naser Musa ,dhe kemi kërkuar nga ai që ti informoj të gjith kshilltarët komunal dhe zyrtarët të tjerë rreth deklarimit të pasurisë së tyre .Në pyetjen e gjyqtarës dëshmitari përgjigjet se kërkesë të veqant për deklarimin e posurisë nuk I kemi dorzuar personave zyrtar nga se këtë nuk e parasheh ligji , mirëpo njoftimin e kemi bërë permes zyrtarit kontaktues Naser Muses .

03-4396/12/02
sluz

Në bazë të deklaratës të të pandehures , dëshmitarve,si dhe shkresave të lëndës, gjyqtarja vlerëson se nuk është dëshmuar me provat të argumentuara se personi kontaktues I komunës së Ferizajit Naser Musa, e ka njohtuar të pandehuren për deklarimin e pasurisë ashtu siq deklaroi si është trajnuar në Agjensionin kundër korruptcionit dhe si të njoftohen zyrtarët për deklarimin e pasurisë, ku deklaroi se e ka pas për obligim ti njohtoj permes imellit ose me dorzim personal , në këtë rast dorzim personal nuk është bërë duke ia dorzuar personalisht njoftimin me nënshkrim të pranuesit pasi që deklarimi I pasurisë në Agjension është obligim me përgjegjësi të lartë .

Gjyqtarja po ashtu konstaton se kërkesa ndaj të pandehures nga Agjensionin kundër Korruptcionit është parashtruar për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjensisë nga neni 5.6 par.1.3 neni 9 dhe neni 17 par.1 pika.3 e Ligjit nr.04/-050/ e jo për deklarimin e rregullt të pasurisë nga neni 5 . 6 par.1.2 neni 8 dhe neni 17 par.1 pika 1. Këto dy lloje të deklarimit të pasurisë dallojnë mes vete thelbësisht sikurse edhe dy lloje të tjera të deklarimit të pasurisë siq janë, me pranimin e detyres dhe me largimin nga detyra.

Nga të lartëcekurat nuk dëshmohet se e pandehura e ka kryer vepren kundërvajtëse, e cila I ngarkohet me kërkesë të Agjensionit kundër Korruptcionit për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës së Agjensisë , e po ashtu edhe perms deklarimit të rregullt siq u tha më lartë nuk dëshmohet se e njejtja është njëftua perms imelit apo me dorzim personal –ividual për deklarimin e pasurisë, andaj ndaj të njejtës në mungesë të provave Pezullohet procedura kundërvajtëse si në vështrim të nenit 198 al.1 pika 8 të LK.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, me datën 29.11.2012 .

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankese Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate, pa pagesë takse.

Sek.juridike
Imrane Shabani

Gjyqtarja
Hysnije Gashi